Struktura përgjegjëse për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore në Bashkinë Maliq përcaktohet në strukturën organizative të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Maliq nr. 147, viti 2025.

Në zbatim të këtij vendimi, funksionet për mbledhjen, administrimin dhe përpunimin e statistikave vendore realizohen nga punonjësit e statistikës të parashikuar në strukturat përkatëse të bashkisë, konkretisht:

- *Në Sektorin e Bujqësisë;*
- *Në Drejtorinë e Pronave;*
- *Në Sektorin e Bashkëqeverisjes dhe Performancës.*

Këto struktura janë përgjegjëse për mbledhjen, administrimin, përditësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore sipas fushave funksionale që mbulojnë, në funksion të planifikimit, monitorimit të performancës institucionale, raportimit vendor dhe hartimit të politikave zhvillimore të Bashkisë Maliq.